



Udhëzues për plotësimin e LIBRIT TË BLERJES

Data: Shëno datën e faturës. Formati duhet të jetë: data / muaji / viti, p.sh. 02.01.2024. Kjo rubrikë është mandatore.

Numri i faturës: Shëno numrin e faturës së blerjes. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

Emri i shitësit: Shëno emrin e plotë të shitësit nga i cili është furnizuar blerësi, p.sh.. "XXXXX" SH.P.K. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit / Numri Fiskal / Numri Personal: Shëno Numrin Unik të Regjistrimit të Biznesit– Shitësit, Numrin Fiskal të shitësit apo Numrin Personal të shitësit . Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit – formati është 9 shifror, fillon me 81... dhe përmban vetëm numra (personi i regjistruar në ARBK). Numri Fiskal - formati është 9 shifror, fillon me 6... dhe përmban vetëm numra (personi i regjistruar në ATK); Numri Personal – formati është 10 shifror, fillon me 1... apo me 2... dhe përmban vetëm numra (personi i regjistruar në ARC). Në rastet kur blerjet janë nga Importet duhet të vendosen numrat sipas tabelës së mëposhtme. Kjo rubrikë është e validueshme dhe është rubrikë mandatore.

Në vijim gjeni sqarimet se si duhet të plotësohet kolona e NUI / NF / NP:

LIBRI I BLERJES	
Vendosja e Numrit në Kolonën e NUI/NF/NP	Përshkrimi
81XXXXXXXX	NUI me 81... vendoset për Blerjet nga personat e regjistruar në ARBK.
60XXXXXXXX	NF me 6... vendoset për Blerjet nga personat që janë të regjistruar në ATK.
1XXXXXXXXX apo 2XXXXXXXXX	Numri Personal me 1....apo 2... vendoset për Blerjet nga personat fizikë jo-afaristë.
8	Numri 8 vendoset për Importet.
0	Zero vendoset në rastet kur Libri i Blerjes deklarohet pa transaksione, pra deklarimi i librit me zero.

[a] Blerjet e mallrave/shërbimeve: Shëno blerjet e mallrave dhe/apo shërbimeve të bëra brenda vendit. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[b] Blerjet për shpenzime: Shëno blerjet (mallra dhe/apo shërbime) për shpenzime të bëra brenda vendit. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[c] Blerjet Investive: Shëno blerjet (mallra dhe/apo shërbime) vendore të cilat janë bërë për qëllime të investimeve. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[d] Importet e mallrave: Shëno importet e mallrave të blera për qëllime të rishitjes së tyre. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[e] Importet Investive: Shëno importet investive. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[f] Blerje të shërbimeve jashtë vendit: Shëno blerjet e shërbimeve të ofruara nga personat jashtë vendit. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[g] Blerjet totale: Formati është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (a + b + c + d + e + f)

Vëmendje: Libri i Blerjes duhet të deklarohet edhe nëse nuk ka transaksione brenda periudhës tatimore. Pra, deklarimi bëhet me zero (0).